



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLAT E MESME SPORTIVE

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË ANGLEZE

**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË ANGLEZE
PËR KLASËN E 13-TË**

Koordinator: Erifili Hashorva

Redaktor letrar:

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, DHJETOR 2010

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të është dokument zyrtar i përpiluar me qëllimin e realizimit të standardeve të mësimdhënies/mësimnxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor **B2** sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët (KPER), duke mundësuar që nxënësi, nga përdorues i nivelit prag i pavarur i gjuhës (B1.2 në klasën e 12-të), të bëhet përdorues i pavarur.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të lidhet në mënyrë harmonike edhe me programet ndërkurrikulare të kësaj klase, duke ndërthurur në mënyrë logjike dhe krijuese njohuritë e përftuara në gjuhën angleze me ato të lëndëve të tjera, si p.sh.: histori, gjeografi, biologji, matematikë, informatikë etj. Ndërthurja ndërlëndore bëhet natyrshëm dhe e nxit nxënës/in,-en drejt punës së pavarur. Dijet e fituara e përgatisin nxënës/in,-en të përballet me studime të mëtejshme, ose i jep mundësi për punësimin e tij/saj brenda ose jashtë vendit.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të për shkollën e mesme sportive, është konceptuar dhe hartuar në mënyrë të tillë që dijet të rimerren, duke u pasuruar dhe thelluar më tej, duke i vetëdijësuar nxënësit për njohuritë gjuhësore të përftuara ndër vite.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të ndjek udhëzimet e Kurrikulës Kombëtare të Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar. Programi ravijëzon të gjitha njohuritë gjuhësore dhe ndërkulturore të përftuara nga klasa e 3-të deri në klasën e 13-të. Ai finalizon njohuritë që nxënësi ka përftuar gjatë gjithë ciklit të shkollës nëntëvjeçare dhe të mesme, si dhe krijon kushtet për një orientim më të mirë të nxënësve në vlerësimin e njohurive përfundimtare.

Programi përcakton kriteret e përmbushjes së standardeve të mësimdhënies / mësimnxënies në përputhje me Portofolin European të Gjuhëve, të akredituar nga Këshilli i Europës për nxënësit shqiptarë të shkollës së mesme. Zbatimi i standardeve është detyrë themelore e mësuesve dhe nxënësve, të cilët duhet të vlerësojnë se sa procesi mësimor përmbush objektivat e përgjithshëm të kurrikulës kombëtare për gjuhët e huaja.

Programi përmbush nevojat dhe interesat gjuhësore e kulturore të nxënës/it,-es, duke i ndërthurur ato me përvojat dhe dijet mbi botën që e rrethon, duke iu përshtatur grupmohës dhe duke nxitur në vazhdimësi zhvillimin e pavarur, intelektual dhe social-kulturor të nxënës/it,-es.

Kështu, programi kërkon që nxënës/i,-ja të rrisë e të thellojë aftësitë e tij/saj formuese dhe shprehëse në gjuhën angleze, duke e bërë atë përdorues/e të pavarur.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të e drejton nxënës/in,-en:

- Të mësojë në mënyrë të pavarur, duke i dhënë atij/asaj besim në vetvete në realizimin e detyrave në klasë e jashtë saj;
- të zhvillojë të menduarit kritik, duke i dhënë mundësi të konsultohet me më shumë burime informacioni dhe të bëjë përzgjedhjen e duhur personale;
- të përgatitet për të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Mësimdhënia/mësimnxënia realizohet me sukses, duke ndërthurur forma të ndryshme të punës individuale dhe të asaj në grup.

1. SYNIMI I LËNDËS

Synimi kryesor i programit të gjuhës angleze për klasën e 13-të është të përmbyllë ciklin e përvetësimit të kësaj gjuhe, duke vënë theksin në aspekte të kulturës dhe të qytetërimit.

Programi synon, gjithashtu:

- Ngulitjen e shprehive të punës së pavarur, në mënyrë që nxënës/i,-ja të arrijë të shfrytëzojë literaturën në gjuhën e huaj dhe veçanërisht në gjuhën e specialitetit, të cilën do ta hasë gjatë studimeve universitare.
- Aftësimin e nxënësit me teknikat bazë të leximit dhe të ligjërimit me shkrim në gjuhë të huaj.
- Zhvillimin e mendimit logjik, sintetik dhe krijues, bazuar në tekste konkrete dhe në situatë reale.
- Përgatitjen e nxënës/it,-es për t'u përballur me kërkesat standarde të provimeve europiane për nivelin B2.

Synimet realizohen duke zbatuar me rigorozitet parimet gjuhësore:

- Gjuha është funksionale (të zhvillohen aftësitë gjuhësore dhe komunikative).
- Mësimi i gjuhës ndërthuret me njohuritë e tjera në mënyre paralele dhe të ndërvarur (Nxënësit mësojnë gjuhën angleze në një kontekst akademik dhe social të caktuar).
- Gjuha përftohet nëpërmjet ndërveprimit (Nxënësve u jepet mundësia të përdorin gjuhën gjatë ndërveprimit në situata reale gjuhësore dhe kulturore).
- Mësimdhënia/mësimnxënia bëhet në mënyrë të përshkallëzuar, ndër vite, si dhe ndryshon nga një individ tek tjetri sipas njohurive të gjuhës mëmë, kushteve sociale dhe kulturore.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të ka si objektiv të përgjithshëm të zhvillojë aftësinë analitike dhe sintetike të një informacioni më të gjerë gjuhësor dhe kulturor, duke e ndërthurur këtë informacion me njohuritë e lëndëve të tjera, ku nxënës/i,-ja zhvillon më tej:

- Shprehitë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të përballuar me shkathtësi dhe saktësi problemet e përditshme përmes formimit të tij/saj gjuhësor dhe kulturor;
- aftësinë për të vënë në dukje, për të krahasuar dhe për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme, si dhe për t'iu përshtatur atyre në situata të caktuara të komunikimit ndërkulturor;
- aftësinë për të ndërthurur sa më mirë kategoritë e njohurive të përgjithshme me ato specifike në përputhje me shprehitë individuale të tij/saj;
- aftësinë e të menduarit në mënyrë krijuese dhe kritike, duke konsoliduar shprehitë dhe/ose proceset e të menduarit kritik dhe krijues;
- shprehitë dhe aftësitë planifikuese dhe përpunuese.

Meqenëse programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të shërben si fazë përmbyllëse për njohuritë e përftuara në gjuhën angleze gjatë viteve të arsimimit në nivelin parauniversitar, nxënësit bëhen më të sigurt dhe të vetëdijshëm në përdorimin e njohurive gjuhësore dhe kulturore në përshtatje dhe në përputhje me nivelin gjuhësor B2.

3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë u japin më shumë rëndësi analizës dhe sintezës gjuhësore, thellojnë ndërveprimin gjuhësor për të ngritur në një nivel më të lartë cilësor komunikimin në gjuhën angleze, në kushte në të cilat nxënës/i,-ja jo vetëm orientohet në ndërveprimin gjuhësor, por edhe argumenton pikëpamjet e tij/saj.

Duke vendosur një standard më të lartë gjuhësor dhe kulturor nëpërmjet sigurimit të informacionit të një shkalle më të lartë vështirësie në këndvështrimin sasior dhe cilësor, programi i klasës së 13-të synon që nxënës/i,-ja të përballojë situata të ndryshme të komunikimit të përditshëm, në një mjedis gjuhësor e kulturor anglishtfolës.

Standardi	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të bëjë parashikime rreth një situatë problemore;• të vlerësojë prezantimin e informacionit/mesazhit të kërkuar ose të dhënë;• të kuptojë thelbin dhe detajet e bisedës;• të bëjë të qartë lidhjet shkak-pasojë në një situatë të dhënë;• të shprehë pikëpamjet mbi një argument, duke e mbështetur me fakte dhe të dhëna;• të krahasojë zgjidhje të ndryshme;• të justifikojë zgjidhjen e parashtuar të një problemi;• të bëjë dallimin mes fakteve dhe interpretimit të tyre;• të klasifikojë pikat e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme të një diskutimi;• të diskutojë rreth argumenteve pro dhe kundër;• të debatojë për të mbrojtur argumentet dhe qëndrimin e tij/saj ndaj një teze apo ideje;• të hartojë një tekst argumentues, duke respektuar rregullat strukturore në situata të ndryshme, si p.sh.: jeta e përditshme, jeta në shkollë, bota përreth nesh, bota e komunikimit, jeta personale dhe shoqërore etj.

<p>Veprimtaritë e komunikimit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të miratojë, duke mirëpritur idetë dhe përvojat e të tjerëve; • të kundërshtojë me argumente, duke mbrojtur pikëpamjen e tij/saj rreth temës së debatit; • të negociojë për zgjidhjen e një ankese; • të bëjë hipoteza; • të shprehë keqardhje dhe dëshira; • të nxisë marrjen pjesë në shtrimin e një platforme diskutimi, duke krijuar mundësi të njëjta për të gjithë; • të shprehë pëlqime dhe mospëlqime; • të verifikojë detajet mbështetëse të një argumenti për përvoja të ndryshme, në situata të jetës së përditshme, si: festa, takime, ditëlindje, treg, vende të panjohura, shkollë, mbrëmje, ekskursionë, diskutime rreth aktualitetit, interesat etj.
--	---

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor, duke vënë theksin në administrimin e aftësive ligjërimore në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor.

Standardi	Objektiva
<p>Kultura</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë gjuhën angleze në mënyrë të drejtë; • të përdorë forma të ndryshme gjuhësore dhe kulturore, si p.sh.: regjistër të përshtatshëm për një situatë, audiencë dhe qëllim të caktuar (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, informale etj.); • të përdorë strategjitë e duhura të të nxënit që ai/ajo të zgjerojë më tej kompetencat e tij/saj social-linguistike dhe social-kulturore; • të thellojë njohuritë e tij/saj mbi personalitete të ndryshme të kulturës angleze, si dhe të ngjarjeve të ndryshme me karakter njohës dhe formues në fushën e gjeografisë, historisë, ekonomisë, politikës, artit etj.;

	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë shenjat jashtëgjuhësore (<i>body language</i>), si p.sh.: gjestet, qëndrimi në ligjërim etj., që përcaktojnë pozicionin e bashkëfolësve në bashkëbisedim; • të motivojë shijet dhe zgjedhjet e të rinjve mbi tregun, çmimet, modën, shkollën, jetën, të ardhmen etj., duke bërë krahasimin me ato të kulturës angleze; • të komentojë mbi vlerat e një filmi, një drame, një koncerti apo një veprë letrare, duke i analizuar dhe duke krahasuar elementet e tyre në sjelljen e personazheve.
--	--

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi. Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të përdorë dhe të aktualizojë elemente gjuhësore që janë në përshtatje dhe në përputhje me nivelin gjuhësor B2, duke i kushtuar rëndësi të veçantë saktësisë dhe rrjedhshmërisë së këtyre elementeve në situata të caktuara ligjërimore, në mënyrë që nxënësit të rrisin shkallën e vetësigurisë dhe ndërgjegjësimit në përdorimin e njohurive gjuhësore.

Nxënës/i,-ja nxitet të përforcojë, të përpunojë dhe të zgjerojë njohuritë për strukturat gramatikore, si dhe të kuptojë lidhjen dhe përdorimin e saktë të tyre në ligjërim, duke zhvilluar më tej kompetencat gjuhësore dhe duke rritur sigurinë në komunikim. Analiza dhe përdorimi i njohurive dhe i strukturave gjuhësore të përfuara në nivelet e mëparshme gjuhësore dhe në vazhdim, në klasën e 13-të bëhet në situata më të ndërlikuara kuptimore dhe gjuhësore me një shkallë më të lartë saktësie dhe përpikërie.

Standardi	Objektiva
<p>Elemente gramatikore</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë pjesë leximi, tregimi etj., nga ana gramatikore për të vlerësuar rrjedhën logjike; • të shpjegojë fjalitë e përbëra, bashkërenditëse dhe nënrenditëse, duke i përdorur saktë ato me një qëllim të caktuar; • të korrigjojë gabimet e bëra në ligjërim me shkrim ose me gojë (Në këtë nivel gjuhësor, nxënës/i,-ja lejohet të bëjë 5-6 gabime të lehta, të cilat mund të shmangen gjatë paraqitjes përfundimtare të detyrës.); • të përdorë saktë në mënyrë krijuese foljen në kohë dhe kombinime të ndryshme; formën veprare dhe pësore të foljes në struktura të

	<p>ndërlikuara; foljet kalimtare e jokalimtare; struktura komplekse të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë; fjalitë e përbëra (kushtore, dëshirore, kohore); dallimet kuptimore në përdorimin e formave të pashtjelluara; lidhëzat; format e ndërlikuara të foljeve frazë e modale; përemrat vetvetorë; përemrat e pacaktuar; rendin e fjalëve në fjali; mbiemrat dhe format e tyre më të ndërlikuara; ndajfoljet dhe nyjat; emrat e përbërë; parashtesat dhe prapashtesat nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme shoqërore dhe akademike.</p>
--	--

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të ndjekë, me pak sforcim, pjesën më të madhe të një bisede autentike bërë në praninë e tij/saj; • të kuptojë në detaje një ligjërime në gjuhë standarde, edhe pse të zhvilluar në një mjedis të zhurmshëm; • të kuptojë idetë kryesore të një ligjërimi të ndërlikuar në brendi dhe formë, mbi një temë konkrete ose abstrakte; • të ndjekë një argument apo debat kompleks, mbi një temë të njohur dhe të strukturuar qartë; • të ndjekë një leksion apo bisedë, të drejtpërdrejtë apo në radio, mbi tema të njohura dhe të panjohura, që lidhen me veprimtarinë personale, shoqërore apo akademike; • të kuptojë dokumentarë televizivë, intervista apo biseda, drama dhe filma, të shprehur në gjuhë standarde; • të përthithë përmbajtjen informative të një materiali të regjistruar, duke dalluar pikëpamjen dhe qëndrimin e folësve, nëpërmjet elementeve të intonacionit që përdoren.

<p>Të lexuarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përvetësojë me shpejtësi përmbajtjen dhe domethënien e lajmeve, artikujve mbi tema që lidhen me interesat e tij/saj (të vendosë nëse një rilexim është i domosdoshëm); • të kuptojë artikuj dhe materiale mbi problemet aktuale, ku shprehen qëndrime dhe pikëpamje të caktuara; • të kuptojë në detaje tekste të ndryshme që lidhen me fushën e tij të interesit akademik dhe shoqëror; • të përmbledhë pikat kryesore në shkrimet kritike rreth filmave, teatrove, librave dhe koncerteve; • të përshkojë shpejt një manual (p.sh., rreth një programi kompjuterik), duke kuptuar shpjegimet e këshillat përkatëse rreth një problemi të caktuar; • të identifikojë shpejt përmbajtjen, duke përzgjedhur informacionin e përshtatshëm nga artikuj dhe reportazhe të ndryshme; • të kuptojë artikuj të specializuar jashtë fushës së tij/saj, duke e lejuar që t'i referohet herë pas here fjalorit, për të verifikuar kuptimin; • të kapë mesazhin kryesor në korrespondencën e përditshme të fushës së tij/saj të interesit.
<p>Të folurit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shprehet rrjedhshëm dhe saktë për shumëllojshmëri temash, duke bërë me lehtësi lidhjen midis ideve; • të komunikojë rrjedhshëm dhe spontanisht gjatë bashkëbisedimit me folës vendës, duke mbështetur qëndrimet me anë të argumenteve dhe shpjegimeve të nevojshme; • të kuptojë hollësisht gjatë pjesëmarrjes në biseda të zgjeruara për çështje të përgjithshme, edhe kur ato zhvillohen në mjedise të zhurmshme; • të shprehë idetë e tij/saj në mënyrë të saktë, duke iu përgjigjur me argumente në mënyrë bindëse; • të vlerësojë propozimet alternative, duke bërë hipoteza dhe duke iu përgjigjur atyre në lidhje

	<p>me tema, përmbajtja e të cilave është e njohur;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të mbështesë mendimet e tij/saj në diskutime, me shpjegime, argumente dhe komente të sakta; • të përballojë kënaqshëm një debat, duke identifikuar qartë argumentet në mbështetje apo kundër pikëpamjes së tij/saj; • të përballojë duke negociuar për zgjidhjen e një problemi që evidentohet; • të raportojë informacione dhe argumente nga një numër burimesh, duke nxjerrë përfundime të drejta; • të japë qartë e rrjedhshëm njoftime për çështje të përgjithshme, pa shkaktuar keqkuptime dhe vështirësi të dëgjuesi.
<p>Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 13-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë qartë një tekst (esë, raport, prezantim etj.) rreth temave të ndryshme, që kanë lidhje me interesat e nxënës/it,-es; • të shkruajë përmbledhje artikujsh për tema të përgjithshme, duke bërë vlerësimin e informacionit përkatës; • të përmbledhë informacione dhe argumente nga burime, duke i vlerësuar ato; • të shtjellojë një temë, nëpërmjet esesë apo raportit, duke theksuar pikat kyçe dhe duke përfshirë në të detajet mbështetëse; • të shkruajë për ngjarje dhe përvoja të vërteta ose të stisura, në mënyrë të detajuar, të qartë e të kuptueshme; • të shkruajë një përmbledhje të shkurtër rreth një filmi apo libri, ku të shprehë edhe qëndrimin e tij/saj rreth tyre; • të raportojë mbi lajmet e ditës, duke shprehur qëndrimin e tij/saj rreth tyre; • të parashtojë idetë dhe zgjidhjet e tij për një problem, duke shpjeguar qartë avantazhet apo disavantazhet e tyre.

5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të është i lidhur ngushtë me programet e lëndëve të tjera, që nxënës/it,-et zhvillojnë gjatë vitit mësimor. Së bashku me njohjen e gjuhës, ata formohen nga ana etike, kulturore dhe intelektuale. Ndërthurja e programeve të klasës së 13-të për shkollën e mesme sportive realizohet nëpërmjet trajtimit të fushave tematike me objektivat dhe synimet përkatëse, të cilat nuk janë vetëm gjuhësore, por edhe njohëse.

Ndërthurja ndërlëndore shprehet si më poshtë:

- Njohuritë që merren në gjuhën angleze dhe *në matematikë*, ndërthuren kur përdoren shifrat, numrat dhe veprimet matematikore në interpretimin e disa të dhënave në përqindje, në diferencë etj.
- Njohuritë që merren në gjuhën angleze dhe *në shkencat natyrore*, p.sh.: në *biologji, kimi, fizikë* reflektohen në trajtimin e temave rreth funksionit të trupit të njeriut, të ekosistemit, të reaksioneve kimike, si dhe të zbatimit të ligjeve të fizikës.
- Në lëndën e TIK-ut, nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë internetin, *e-mail-in*, programe të ndryshme që e ndihmojnë atë të eksplorojë të rejtat mbi botën që studion, si dhe të vendosë komunikim me bashkëmoshatarët e tij/saj.
- Njohuritë që ai/ajo merr nëpërmjet artit dhe kulturës angleze, gjejnë shprehjen e tyre në aktivitetin dhe kontributin e personaliteteve në fushën e sportit, muzikës, modës dhe pikturës.
- Me *shkencat sociale* janë të lidhura tema, si: marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, marrëdhëniet në komunitet, të cilat vihen në zbatim përmes projekteve ndërkurrikulare mbi ndihmën ndaj të varfërve, të moshuarve, personave me kufizime mendore dhe fizike etj.

Bashkëndimi ndërlëndor në programin e klasës së 13-të mundëson realizimin e synimeve dhe objektiveve të përgjithshëm të programit për:

Edukimin intelektual. Gjatë njohurive që nxënës/i,-ja merr në këtë nivel shkollimi, i cili përbën dhe mbylljen e ciklit mësimor të shkollës së mesme artistike, gjatë analizës dhe sintezës ai/ajo arrin t'i vlerësojë këto njohuri, duke rritur cilësinë e nxënies dhe pavarësinë e tij/saj të të nxënit.

Edukimin mjedisor. Për sa i përket *edukimit mjedisor*, programi mundëson tema në funksion të këtij zhvillimi. Në këtë aspekt, nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë struktura gramatikore më të ndërlikuara, forcon aftësitë shprehëse gjuhësore, duke krahasuar dhe duke analizuar shkaqet, pasojat dhe zgjidhjet.

Edukimin kulturor dhe etik. Përmes lëndëve historii, gjeografi, letërsi e historii arti nxënës/i,-ja përfton njohuri për vendet anglishtfolëse, për kulturën, për mënyrën e jetesës, për etikën, për doket e zakonet, duke e bërë atë të aftë të përballet në sfidat e mëtejshme për t'u bërë qytetar/e i/e botës. Edukimi kulturor dhe etik realizohet përmes përdorimit të funksioneve gjuhësore, si p.sh.: të kërkojë falje e sqarime, të shprehë keqardhje e gëzim, miratim apo kundërshtim etj., në kontekste ndërveprimi të ngjashme me ato reale.

Edukimin për të drejtat e njeriut. Njohja e kulturave dhe e personaliteteve të vendeve anglishtfolëse, i jep shtysë trajtimit të temave, si: barazia sociale, mosdiskriminimi social,

respekti reciprok, barazia gjinore dhe racore.

Atdhedashurinë. Njohja me historinë, me personalitetet dhe me kulturën e vendeve anglishtfolëse i jep mundësi nxënës/it,-es të bëjë dallimin dhe të nxjerrë anët e përbashkëta, duke e ndërgjegjësuar atë për identitetin kombëtar dhe kulturor.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të për shkollën e mesme sportive është dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës angleze, si kurrikula dhe standardet e fushës kurrikulare, ku kjo lëndë bën pjesë. Ky program reflekton hapat që përdoruesit (p.sh.: mësuesit, instruktorët, nxënësit) ndërmarrin gjatë planifikimit të procesit të mësimdhënies/mësimnxënies dhe të vlerësimit.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të dallohet për dhënien në formë spirale të kompetencave gjuhësore dhe të njohurive kulturore. Kjo nënkupton përsëritjen dhe rimarrjen e tyre në veprimtari dhe në kontekste gjuhësore gjithnjë e në rritje. Për këtë arsye, përdoruesve të programit u duhet të njihen me programet lëndore të gjuhës angleze për klasat paraardhëse, si dhe me nivelet gjuhësore A1, A2, B1, B2, sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe të Portofolit European për Gjuhët, të akredituar nga Këshilli i Europës.

Meqenëse programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të lidhet në mënyrë organike me programet e lëndëve të tjera, përdoruesve u duhet të njohin jo vetëm standardet e fushave të tjera të të nxënësve, por dhe programet lëndore të së njëjtës klasë.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të realizohet vetëm duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të zbatohet nëpërmjet hartimit individual të planeve vjetore, semestrale dhe ditore, ku mësues/i,-ja ka liri veprimi në përputhje me nevojat e nxënës/it,-es dhe në përputhje me kërkesat e Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët.

A. Objektivat

Objektivat e parashtruar në programin e gjuhës angleze për klasën e 13-të janë të detyrueshëm për t'u realizuar nga mësues/i,-ja dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë atë çfarë përshkruhet tek objektivat. Objektivat janë të detyruara të zbatohen sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqenëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënës/it,-et e tij/saj. Kjo kërkon që, përveç përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, mësues/i,-ja të përcaktojë objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

B. Orët mësimore

Programi i gjuhës angleze për klasën 13-të është strukturuar sipas një formati, i cili jep standarde sipas fushave dhe objektiva për secilin standard fushe; gjithashtu, programi jep dhe objektiva për çdo aftësi, të cilat synojnë atë që mësuesi do të arrijë në përfundim të vitit shkollor për këtë lëndë.

Sasia e orëve mësimore është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Kjo do të thotë se mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës angleze, afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha angleze për klasën e 13-të zhvillohet me 2 orë mësimore në javë:

33 javë x 2 orë = 66 orë vjetore.

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në module e njësi mësimore), fushat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësues/i,-ja është i/e lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një moduli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes dhe shpërndarjes së orëve për sa vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 46 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në **33** orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 23 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 10 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni); dhe në **13** orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (70% e tyre, që përbëjnë 9 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës. Ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 20 orë. Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 14 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 6 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin).

Realizimi i orëve të fushave është sa i detyrueshëm, aq edhe elastik. Kështu: 10% të orëve sipas fushave tematike, mësues/i,-ja është i/e lirë t'i transferojë te një fushë tjetër, në varësi të nevojave të nxënës/ve,-eve.

Sugjerohet që përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës angleze për klasën e 13-të të realizohet përmes fushave tematike jodetyruese, të cilat gjejnë pasqyrim në tema si më poshtë: shokët, personaliteti, komuniteti, udhëtimet, figurat historike, shkrimtarët, artistët,

këngëtarët, llojet e veglave muzikore, trupi dhe shëndeti, sportet, ushqimet dhe ushqyerja, gjeografia e gjuhës, mënyra e jetesës, profesionet e ndryshme, blerjet, shpikësit dhe shpikjet, teknologjia, zhvillimet aktuale shkencore etj.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme.);
- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive, duhet t'u kushtohet kohë e posaçme:

- Kultivimit të aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit kritik e krijues;
- kultivimit të aftësive gjuhësore: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si: qëndrimi etiko-social, qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish etj.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të nxiten nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënës/ve,-eve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 13-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies/mësimnxënies së gjuhës angleze në nivelin B2.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies

Mësues/i,-ja është i/e lirë të përdorë larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/mësimnxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai/ajo i kombinon metodat gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë për katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- të arsyetojë mbi bazë të asaj që dëgjon;
- të përdorë njohuritë e tij/e saj të mëparshme;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- të përpiqet që gjatë dëgjimit të kuptojë referencat kulturore të panjohura për të, duke përdorur kontekstin, për të hamendësuar kujt ato i referohen.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit përsëritje, në rast moskuptimi;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- të përdorë shprehje tipike të gjuhës angleze, me qëllim që të fitojë kohë për gjetjen e fjalës së duhur;
- të përsërisë një pjesë të asaj që thotë bashkëfolësi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura në kontekst;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të hamendësojë përgjigjet e mundshme;
- të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor dhe detajet përkatëse;
- të mbajë shënime gjatë një bisede ose diskutimi, për të përmbledhur mendimin e tij/saj.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të redaktojë shkrimin e tij/saj ose të këmbëjë punën e tij/saj me atë të shokut/shoqes.

C. Parime për zbatimin e programit

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të rrit njohuritë gjuhësore të nxënës/it,-es përmes temave që u përshtaten interesave dhe nevojave të tij/saj gjuhësore dhe shoqërore, duke i dhënë mundësi nxënës/it,-es të jetë në qendër të procesit mësimor. Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes bën që ai/ajo të marrë pjesë aktive në ndërveprim gjuhësor, duke e përgatitur për një fazë të re të shkollimit të tij/saj apo për të qenë i/e aftë të përballet me kërkesat e tregut të punës.

Strategjitë e parashikuara nxisin ndërveprimin gjuhësor dhe komunikativ, duke e përfshirë nxënës/in,-en edhe në organizimin e veprimtarive dhe në përdorimin e teknikave që i përshtaten individualitetit të tij/saj.

Krijimi i mjedisit të të nxënit

Krijimi i një atmosfere gjuhësore motivuese dhe konkurruese, si dhe i një ambienti fizik të rehatshëm dhe miqësor, emocional dhe akademik, rrisin rezultatet e mësimdhënies/mësimnxënies.

Krijimi i mjedisit të përshtatshëm të të nxënit lehtëson përdorimin e formave të bashkëpunimit në klasë, si p.sh., punën në çifte apo në grupe.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja dhe nxënësit bashkëpunojnë për organizimin e mësimdhënies/mësimnxënies. Për ta lehtësuar mësimdhënien/mësimnxënien, mësues/i,-ja gjen mënyra frytdhënëse për të organizuar veprimtaritë komunikuese, siguron dhe sugjeron materiale burimore për nxënësit etj.

Në mësimdhënien bashkëkohore, mësues/i,-ja, përpos rolit mësimdhënës, luan edhe rolin e mbikëqyrësit. Së bashku me nxënësit ai/ajo vendos marrëdhënie bashkëpunimi në procesin e nxënies. Mësues/i,-ja i qartëson nxënësit dhe merr mirëkuptimin e tyre për atë çfarë ndodh në klasë. Kjo nënkupton sqarimin e rregullave të radhës së punës dhe përgjegjësi të nxënësve në procesin e kryerjes së veprimtarive.

Mësues/i,-ja sugjeron dhe siguron përdorimin e mjeteve dëgjimore-pamore, elektronike, dhe ndihmon nxënës/in,-en në përdorimin e formave të ndryshme të teknologjisë informative brenda dhe jashtë klase. Ai/ajo u jep nxënësve *website* në përputhje me moshën dhe kërkesat shkollore.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësues/i,-ja krijon kushtet për realizimin e mësimit në mënyrë bashkëkohore, kryesisht në grupe apo çifte, kështu që ai/ajo siguron ndërveprimin gjuhësor dhe bashkëpunimin mes nxënësve gjatë organizimit të veprimtarive në klasë. Ai/ajo përdor forma të larmishme që u përshtaten nivelit dhe veçorive individuale të nxënësve. Ato ndryshojnë nga ndërveprimi në çift apo në grup, në debatin e hapur për gjithë klasën. Këto forma i bëjnë nxënësit më bashkëveprues, më të pavarur në shprehjen e mendimit të tyre dhe respektimin e ideve të të tjerëve. Gjithashtu, gjatë bashkëpunimit për kryerjen e detyrave në grup, nxënësit mësohen të ndajnë dhe të mbajnë përgjegjësi për produktin e përbashkët. Ky kontekst nxit dhe zhvillon aftësitë gjuhësore në mënyrë të natyrshme, duke përfituar nga njohuritë e të tjerëve, si dhe duke korrigjuar veten dhe të tjerët.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor B2, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën angleze në situata reale, si p.sh.: në kryerjen e veprimtarive gjuhësore, në dhënien e udhëzimeve për punët e përbashkëta në projekte, ku ka ndarje dhe përgjegjësi ndaj detyrave të ngarkuara.

Të mësuarit e gramatikës

Në kuadër të respektimit të Kuadrit të Përbashkët të Referencave për Gjuhët, gramatika mësohet në bashkëveprim dhe në një kontekst kuptimplotë, të cilat në nivelin B2 janë më të ndërlikuara.

Njohuritë gjuhësore janë në shërbim të funksionit komunikativ të gjuhës, cilësia e të cilit varet nga saktësia gramatikore dhe rrjedhshmëria gjuhësore, ku nxënësit i lejohej të bëjë deri në 5-6 gabime.

Puna e diferencuar me nxënësit

Meqë niveli i aftësive gjuhësore të nxënësve është i ndryshëm në klasë, mësues/i,-ja ndërton punë të diferencuar për të arritur objektivat për klasën e 13-të. Për arsye të temperamenteve të ndryshme psikologjike dhe të aftësive perceptuese individuale të nxënësve, mësues/i,-ja përdor larmi teknikash, metodash, strategjish apo formash vlerësimi për të lehtësuar përfundimin e gjuhës, si p.sh.:

- Të dëgjojë me kujdes nxënësit, kur flasin, dhe t'u japë përgjigje në kohën e duhur;
- të ndjekë ecurinë e çdo individi duke mbajtur shënimet përkatëse;
- të ndajë përgjegjësitë e nxënësve për veprimtaritë individuale apo në grup;
- të vlerësojë periodikisht punën e nxënësve jo vetëm me notë, por edhe me komente për punën e tyre;
- të kërkojë prej nxënësve mendime dhe sugjerime të punës, me qëllim që të përmirësojë mësimdhënien;
- të motivojë nxënësit të zhvillojnë strategjitë e tyre individuale të të mësuarit të gjuhës angleze;
- të nxisë pjesëmarrjen e nxënësve indiferentë në punën në grup dhe të nxjerrë në pah punën e tyre në klasë, duke u dhënë role drejtuese në punët në grup.

7. VLERËSIMI

Programi i gjuhës angleze për klasën e 13-të, si program përmbyllës i shkollës së mesme sportive, kërkon zbatimin me rigorozitet të udhëzimeve për përdorimin e programit të klasës së 13-të dhe vlerësimin bashkëkohor të dijeve të nxënës/it-es, që ka në bazë vlerësimin komunikativ me shkrim dhe me gojë gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo metodë vlerësimi mbështetet në Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin European për Gjuhët, i cili jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben edhe për përmirësimin e këtij procesi.

Ky vlerësim siguron:

- Një matje të vazhdueshme të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën angleze;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore dhe të metodave të mësimdhënies, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një plan pune për përmirësimin e njohurive të nxënës/it,-es;
- një përgjegjshmëri të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies (nxënës, mësues të gjuhës angleze dhe ndërlëndorë, drejtorja e shkollës, inspektori i arsimit për gjuhën angleze dhe, detyrimisht, edhe prindërit).

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program. Vlerësimi duhet t'i përmbahet vetëm standardeve që përkojnë me nivelin B2, të parashtruara në program.

Vlerësimi nuk përfshin vetëm realizimin e standardeve rreth njohurive dhe aftësive, por edhe rreth qëndrimeve të nxënësve, si p.sh., qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm, gjë që tregohet më së miri në realizimin e standardeve. Mësues/i,-ja vlerëson vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin larmi mënyrash vlerësimi e vetëvlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (në bazë niveli), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë që është mësuar gjatë një jave, një muaji ose një semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijës është i bazuar në orën e mësimit. Kështu, ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es.

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive, ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çfarë nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon çdonjërit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë mjaft të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: eksperimenton, përgatit një prezantim në *Power Point*, harton një projekt etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësim formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe rreth përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Gjithashtu, ai jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/mësimnxënies.

Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të mësimit, pra në bazë kapitulli ose të një ore mësimore. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës (ose kapitulli).

Vlerësim motivues, i cili ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësues/i,-ja e realizon këtë lloj vlerësimi, duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si p.sh.: *Well, Very good, Right* etj., dhe duke përdorur materiale që nxisin vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh.: përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënës/it,-es si pjesë e Portofolit Europian të Gjuhëve, ku ai vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj., që provojnë ecurinë e tij/saj në gjuhë.

Vlerësimi me notë

Vlerësimi i nxënës/it,-es bëhet me notë sipas sistemit të vlerësimit të vendosur nga MASH-i dhe AVA. Ky vlerësim nuk përfundon me vendosjen e notës. Ai përqendrohet tërësisht në monitorimin dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve të përfutuara në vazhdimësi, si dhe të rezultateve të arritura gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies, kryesisht kur gjuha angleze është provim përfundimtar si lëndë me zgjedhje.

Vlerësimi përfundimtar

Në përfundim të semestrit të parë, për çdo nxënës/e përllogaritet nota semestrale dhe, në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it-es, të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe asaj vjetore. Peshë e një note përcaktohet nga lloji i saj.

Janë katër lloje notash:

- nota e vlerësimeve të përditshme,
- nota e provimeve periodike me shkrim,
- nota e punimeve të nxënësve,
- nota e provimit përfundimtar (nëse mësuesi e zhvillon edhe këtë).

Duhet treguar kujdes që:

- Para testimit të jepet një model, që t'u tregohet nxënësve se si do të bëhet testimi.
- Të caktohen më parë qëllimet e testimit, për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.
- Në rastet kur testet hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme, ato të grupohen sipas llojit të tyre, p.sh., pyetje me zgjedhje të shumëfishtë bashkë, ato me çiftim bashkë e kështu me radhë.

Disa udhëzime për vlerësimin

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash. Ato duhet t'u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo individ. Kështu p.sh., një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim, njëri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo etj.

Vlerësimet e përfundimeve të nxënësve të trajtohen me kompetencë e jo si mesatare aritmetike e notave të vlerësimit formues.

Të kihet parasysh që përparimi i nxënës/it,-es, si dhe një gjykim përmbledhës në përfundim të periudhës bazuar në objektiva, përbën vlerësimin përfundimtar. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe mosanaliza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korrigjimit të gabimeve.

Shënimet të jenë të thjeshta, por të pasura. Është e domosdoshme që, përveç regjistrit të klasës, mësues/i,-ja të mbajë shënime të tjera për punën e çdo nxënës/i,-eje dhe

të krijojë një portofol të punës së tij me nxënësit. Ato ndihmojnë në njohjen dhe në vlerësimin e arritjeve, në diagnostikimin e në riparimin e vështirësive dhe lehtësojnë vlerësimet përmblendhëse.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, si dhe ndihmon nxënësit dhe, së bashku, zhvillojnë larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- Teste me shkrim, për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit;
- monitorimin e punës në grup të nxënësve;
- punët eksperimentale, raportet e punës;
- projektet, prezantimet e kërkimeve.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e shkurtra disaminutëshe për një objektiv të veçantë të nxënësve, tek ato njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për gjuhën angleze. Portofoli i nxënës/it,-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, përjashtuar vlerësimin me shkrim apo me gojë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti, sipas detyrave të tij/saj në grup.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës angleze, ku secili/secila nxënës/e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit të njohurive nga mësues/i,-ja, nga prindërit dhe nga institucionet arsimore. Vetëvlerësimi ka efekt, kur:

- U referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Përbashkët Europian i Referencave për Gjuhët parashtron për grupmohën dhe nivelin e nxënësve,
- lidhet me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vetëvlerësimi i nxënies bëhet i matshëm nëpërmjet përcaktimit të synimeve të qarta në program. Si mjet në vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj), i cili, me anë të tri pjesëve të tij (Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes), nxit nxënës/in,-en të mendojë mbi nivelin e tij/saj gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij/saj gjuhësore, të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

PEGj-i është dokumenti ku çdo nxënës shënon eksperiencat dhe njohuritë e tij gjuhësore e kulturore. PEGj-i nxit nxënës/in,-en të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij/saj në fushën e gjuhëve. Përdorimi i PEGj-it favorizon lëvizjen në Europë, duke informuar aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe tregon arritjet e tij/saj.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi. Ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënëet e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.